



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I BASHKIAK PUKE

Nr. 1364 Prot

Pukë, më 20.08.2026

NJOFTIM PËR KONSULTIM PUBLIK

TITULLI: Konsultim publik për dhënien në përdorim të fondit pyjor publik për vendosjen e stacioneve dhe bazamenteve për instalimin e turbinave eolike për prodhimin e energjisë elektrike

QËLLIMI: Konsultimi publik ka për qëllim përfshirjen e grupeve të interesit dhe komunitetit në procesin e vendimarrjes, duke i informuar dhe duke u krijuar mundësinë për të shprehur mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre lidhur me një nga çështjet që do të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Bashkiak Pukë.

Këshilli Bashkiak Pukë do të organizojë takimet e konsultimit publik me grupet e interesit dhe komunitetin, me qëllim marrjen në konsideratë të mendimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve të tyre përpara marrjes së vendimit.

Konsultimi zhvillohet në përputhje me dispozitat e **Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”**, veçanërisht nenet 18 dhe 54, si dhe kuadrin ligjor në fuqi për informimin dhe konsultimin publik.

DATA DHE VENDI I ZHVILLIMIT TË KONSULTIMIT:

Njësia Administrative Pukë – Kodër Hani

Data: 09.09.2026

Ora: 17:00

Njësia Administrative Qerret

Data: 09.09.2026

Ora: 11:00

Njësia Administrative Gjegjan

Data: 10.09.2026

Ora: 10:00

Vendi: Shkozë

Data: 10.09.2026

Vendi: Gojan i Madh

Ora: 11:00

Data: 10.09.2026

Vendi: Gjegjan

Ora: 12:30

Ftohen të marrin pjesë në këto takime të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe subjektet e tjera të interesuara, të cilët mund të paraqesin mendimet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre lidhur me çështjen objekt konsultimi.

Pershkrimi i konsultimit	Dhënien në përdorim të fondit pyjor publik për vendosjen e stacioneve dhe bazamenteve për instalimin e turbinave eolike për prodhimin e energjisë elektrike në ekonomitë pyjore “Tërbun”, “Livadh-Hamëz”, “Kuzhnen”, “Gojan-Shkozë” dhe Gomsiqe.
Sygjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet	Komentet e grupeve të interesit jepen në ditën e zhvillimit të konsultimit

Të gjithë të interesuarit janë të mirëpritur të marrin pjesë.

Për më shumë informacion:

Kontakti/ email : bashkiapuke@yahoo.com

Web: www.bashkiapuke.gov.al

KRYETARI I KËSHILLIT

GJON GJOKA

